

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme të mbajtur më 20.09.2024, në pajtim me nenin 37, paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për Gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2) dhe neni 65 paragrafi (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke vendosur mbi iniciativën për përcaktimin e qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor të parashtruar nga Gjykata Themelore Penale Shkup – Departamenti i procedurës paraprake, V KOKPP nr.32/19, e regjistruar nën Su-03 nr.408/24 të datës 17.06.2024, nxori këtë:

## **K O N K L U Z I O N**

Iniciativa për përcaktimin e qëndrimit parimor ose mendimit juridik parimor e parashtruar nga Gjykata Themelore Penale Shkup – Departamenti i procedurës paraprake, V KOKPP nr.32/19, e regjistruar nën Su-03 nr.408/24 të datës 17.06.2024, **NUK MIRATOHET.**

## **A r s y e t i m**

Në pajtim me nenin 37, paragrafi (1), nënpika 1 të Ligjit për Gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 96/19), në Seancën e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më datë 20.09.2024 u diskutua mbi iniciativën për përcaktimin e qëndrimit parimor ose mendimin juridik parimor për pyetjen e parashtruar se cili organ duhet të vendosë për shpenzimet e avokatit mbrojtës, kur hetimi kundër të dyshuarit është ndërprerë, e parashtruar nga Gjykata Themelore Penale Shkup – Departamenti i procedurës paraprake, V KOKPP nr.32/19.

Në iniciativë është sqaruar se në Gjykatën Themelore Penale Shkup nga i dyshuari Hristijan Delev, përmes mbrojtëses së tij Svetllana Saviq, avokate nga Shkupi, ka dorëzuar listën e shpenzimeve për mbrojtjen e të dyshuarit, në procedurë e cila është zhvilluar në PTHP për NKOK me KO nr. 9/19, për propozimin e paraqitur për caktimin e masës së paraburgimit. Në Gjykatë lënda është e regjistruar nën KOKPP nr.32/19-4.

Nga përmbajtja e iniciativës konstatohet se me datë 31.01.2019 nga PTHP për NPKOK është lëshuar urdhër për zhvillimin e procedurës hetimore ndaj të dyshuarit Hristijan Delev, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale - “Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit” nga neni 353 paragrafi (5) në lidhje me paragrafin (1) të Kodit Penal. Më 31.01.2019 në Gjykatë është dorëzuar propozim për caktimin e masës së paraburgimit kundër të dyshuarit Hristijan Delev në pajtim me nenin 165 paragrafi (1) pika 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurë Penale, për shkak

të ekzistimit të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale - "Keqpërdorimi i pozitës zyrtare dhe autorizimit" nga neni 353 paragrafi (5) në lidhje me paragrafin (1) të Kodit Penal. Nga Gjykata propozimi për caktimin e masës së paraburgimit është miratuar dhe të dyshuarit Hristijan Delev i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 30 ditësh, duke llogaritur nga data 01.02.2019 deri më datën 03.03.2019, në pajtim me nenin 165 paragrafi (1) pika 1 dhe 2 të Ligjit për Procedurë Penale. Më 27.12.2021 nga PTHP për NKOK është lëshuar urdhër për ndërprerjen e procedurës hetimore ndaj të dyshuarit Hristijan Delev. Mbrojtësja Svetllana Saviq, avokate nga Shkupi, në gjykatë ka dorëzuar listën e shpenzimeve të mbrojtjes me prova, të cilën Gjykata më pas e ka dorëzuar në PTHP për NKOK Shkup, si kompetente për të vepruar, në pajtim me nenin 103 të Ligjit për Procedurë Penale. Nga PTHP për NKOK Shkup, lista e shpenzimeve sërish është kthyer në gjykatë, me arsyetimin se kompetente për vendimmarrje ndaj listës së dorëzuar të shpenzimeve është gjykata, në rastin konkret gjyqtari i procedurës paraprake.

Po ashtu, në Iniciativë përmendet se sipas Komentit të Ligjit për Procedurë Penale nga Nëntori i vitit 2018, me dispozitën nga neni 103 të Ligjit për Procedurë Penale është përcaktuar se vendimi i Gjykatës për shpenzimet e procedurës penale është pjesë përbërëse e çdo vendimi, me të cilën mbaron procedura penale. Mirëpo, ligji nuk parashikon mundësinë e marrjes së një vendimi të veçantë për shpenzimet e procedurës penale në rast kur mungojnë të dhëna për shumën e shpenzimeve, kërkesa me të dhënat mund të parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit të aktgjykimit të formës së prerë, apo aktvendimit.

Në pajtim me nenin 102 paragrafi (4) të Ligjit për Procedurë Penale, shpenzimet nga paragrafi (2) pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, si dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit të caktuar dhe autorizuesit të emëruar, në procedurën për veprat penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare, paguhen paraprakisht nga mjetet e organit që zhvillon procedurën penale, ndërsa pagesat kryhen më vonë nga personat të cilët janë të detyruar t'i kompensojnë sipas dispozitave të këtij Ligji. Organi që zhvillon procedurën është i detyruar që të gjitha shpenzimet që janë paguar t'i shënojë në fletëregjistrin i cili do t'i bashkëngjitet shkresave.

Sipas nenit 103 të Ligjit për Procedurë Penale, në çdo aktgjykim dhe aktvendim me të cilin ndërpritet procedura penale, do të vendoset se kush do t'i bartë shpenzimet e procedurës dhe sa janë ato.

Pra, çdo aktgjykim i miratuar pavarësisht nga karakteri i tij, pa marrë parasysh se a bëhet fjalë për aktgjykim dënues, lirues apo refuzues, si dhe aktvendim për ndërprerje të procedurës penale, domosdoshmërisht përmban vendim për shpenzimet e procedurës penale.

Po ashtu, duke pasur parasysh se procedura penale mund të përfundojë edhe me aktvendim për refuzimin e procedurës penale (nëse Prokurori Publik ka bërë shpenzime për kryerjen e disa veprimeve hetimore, gjegjësisht shpenzime të tjera në procedurë), si dhe çdo urdhër për ndërprerje të procedurës penale nga Prokurori Publik,

edhe pse në Ligj nuk është e shënuar qartësisht, duhet të përmbajë vendim për shpenzimet.

Në rastin konkret, Gjykata Themelore Penale Shkup vlerësoi se për marrjen e urdhrit për zbatimin e procedurës hetimore nga PTHP për NKOK Shkup, procedura ka filluar dhe është zhvilluar në PTHP për NKOK Shkup. Gjithashtu, është konstatuar se nga Prokurori Publik me urdhër për ndërprerjen e procedurës hetimore është ndërprerë procedura dhe vendimi është përfundimtar ndaj të dyshuarit Hristijan Delev.

Nga këtu, duke marrë parasysh dispozitat ligjore të cituara më lartë, Gjykata Themelore Penale Shkup vlerësoi se në rastin konkret, kompetent për vendimmarrje për shpenzimet – aktvendim është PTHP për NKOK Shkup, sepse në lëndën konkrete nuk është paraqitur aktakuzë që Gjykata të sjellë aktgjykim pavarësisht nëse bëhet fjalë për aktgjykim dënues, lirues apo refuzues, kur do të ishte e detyruar dhe kompetente të sjellë vendim për shpenzimet. Gjykata është kompetente vetëm për të vepruar për shpenzimet e bëra në procedurë penale, në pajtim me nenin 105 dhe nenin 106 të Ligjit për Procedurë Penale, në të cilat është parashikuar mënyra se kur Gjykata në procedurë penale sjell aktvendim për shpenzime dhe në cilën fazë të procedurës penale.

Nga këtu, në Ligjin për Procedurë Penale nuk është parashikuar se kush sjell aktvendim për shpenzime, në rastin kur nga Prokurori Publik me urdhër është ndërprerë procedura penale, ndërsa të gjitha veprimet procedurale nga fillimi i hetimit deri në ndërprerjen e tij janë ndërmarrë nga PTHP për NKOK Shkup, në kuptim të nenit 103 të Ligjit për Procedurë Penale.

Në shtojcë të iniciativës nuk janë dorëzuar shkresa apo prova materiale.

Në pajtim me nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për Gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 96/19), Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Seancën e përgjithshme përcakton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore për çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit me zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej 3-tre muajve, por jo më shumë se 6-gjashtë muaj me vetiniciativë, me iniciativën e Kryetarit të Gjykatës, ose me iniciativën e Seancës së gjykatësve, ose Departamentet Gjyqësore të Gjykatave, ose me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në web faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në rastin konkret, siç shihet nga përmbajtja e iniciativës së paraqitur duke pasur parasysh se PTHP për NKOK Shkup ka lëshuar urdhër për ndërprerjen e procedurës hetimore ndaj të dyshuarit, në pajtim me dispozitat e nenit 103 të Ligjit për Procedurë Penale, çdo vendim i marrë pavarësisht nga natyra e tij, duke përfshirë edhe aktvendimin për ndërprerjen e procedurës penale, në mënyrë të detyrueshme përmban vendim për shpenzimet e procedurës penale.

Duke marrë parasysh se procedura ka përfunduar me urdhër për ndërprerjen e procedurës hetimore, të lëshuar nga Prokurori Publik, nëse Prokurori Publik ka bërë shpenzime për kryerjen e disa veprimeve hetimore, gjegjësisht shpenzime tjera në procedurë, si dhe çdo urdhër për ndërprerjen e procedurës penale nga Prokurori Publik, edhe pse në Ligjin për Procedurën Penale nuk është theksuar qartë, duhet të përmban vendim për shpenzimet.

Në rastin konkret, nga përmbajtja e iniciativës kërkohet interpretim të dispozitës së nenit 103 të Ligjit për Procedurën Penale.

Mirëpo, Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut konstaton se në këtë situatë konkrete juridike, dukshëm nga përmbajtja e iniciativës nuk është përcaktuar nevoja për unifikimin e praktikës gjyqësore, e as që rezulton një gjë e tillë nga përmbajtja e iniciativës se në procedurë ka praktikë të ndryshme gjyqësore, që në pajtim me nenin 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit për Gjykatat, Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të diskutojë dhe të përcaktojë qëndrim parimor, ose mendim juridik parimor për çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve.

Nga këtu, Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk ka vendime të ndryshme gjyqësore për ekzistimin e bazës në pyetjen e parashtruar nga parashtruesi i iniciativës.

Në bazë të së lartë përmendurës, Seanca e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut duke vepruar për iniciativën, dhe pas diskutimit të mbajtur nxori Konkluzion me të cilin iniciativa për përcaktimin e qëndrimit parimor ose mendimit parimor juridik të parashtruar nga Gjykata Themelore Penale Shkup – Departamenti i procedurës paraprake, V KOKPP nr. 32/19, evidentuar nën Su-03 nr. 408/24 të datës 17.06.2024, nuk miratohet.

**Seanca e Përgjithshme e  
Gjykatës Supreme të  
Republikës së Maqedonisë së Veriut**